Përshkrimi i Vlerësimit	<p>Testi I dhe Testi II - përbëjnë instrumente formale të vlerësimit afat-mesëm dhe final. Testi i parë zhvillohet në javën e shtatë, ndërsa i dyti në javën e fundit të semestrit. Të dy testet përfshijnë pyetje të shumëllojshme, të dizajnuara për të matur kompetencat teorike dhe praktike të studentëve. Kohëzgjatja e testeve është nga 45 deri në 90 minuta. Përmbajtja e tyre synon të vlerësojë aftësitë e studentëve në vlerësimin kritik të koncepteve të hulumtimit, identifikimin e metodave kërkimore, analizën ekonometrike, si dhe formulimin e komponentëve bazë të një projekti shkencor. Ky instrument adreson (RP: 1, 2, 3, 4, 5).</p>	
	<p>Projekti Hulumtues - projekti hulumtues është një komponent qendror i vlerësimit dhe synon integrimin e njohurive teorike me aplikimet praktike të metodologjisë së kërkimit. Projekti duhet të jetë nga 3000 deri në 3500 fjalë dhe vlerësohet sipas tri kriterëve: struktura, përmbajtja shkencore, dhe prezantimi profesional. Përmes këtij projekti, studentët demonstrojnë aftësinë për të dizajnuar një studim kërkimor, për të formuluar pyetje dhe hipoteza hulumtuese, për të aplikuar metoda kuantitative ose kualitative, si dhe për të analizuar të dhënat përmes modeleve ekonometrike. Projekti është obligativ dhe paraqet kusht për qasjen në provimin përfundimtar. Ky instrument adreson (RP: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7).</p>	
	<p>Aktiviteti dhe Kuizet - Aktiviteti gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, së bashku me kuizet periodike, përfaqësojnë instrumente të vlerësimit formativ. Studentët vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, aftësinë për të kontribuar në diskutime akademike, si dhe për kompetencën në zgjidhjen e problemeve kërkimore të prezantuara gjatë kursit. Ky instrument ndihmon në monitorimin e progresit të vazhdueshëm të studentëve dhe</p>	

	kontribuon në arritjen e të gjitha rezultateve të pritshme të lëndës. (Ky instrument adreson RP: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7).
Burimet dhe Mjetet e Konkretizimit	Burimet Numri
	Klasë 1
	Laborator IT 1
	Moodle 1
	Stata/ SPSS 1
	Miro/Slido 1
ECTS Ngarkesa	Aktiviteti Ngarkesa Totale
	Ligjërata 24
	Seminar 12
	Ushtrime 24
	Simulime dhe Aplikim 12
	Mësim i Pavarur 75
	Provime 3
Literatura/Referencat	Literatura Primare: 1. Research Methods: A Practical Guide for the Social Sciences, Bob Matthews dhe Liz Ross, 2010. ISBN: 978-1405858502. 2. Research Methodology: Methods and Techniques, Chandra Radhakrishnan Kothari, 2019. ISBN: 978-9386649225. 3. Research Methods for Business: A Skill-Building Approach, Uma Sekaran dhe Roger Bougie, 2017. ISBN: 978-1119165552. 4. Materiali i përgatitur nga ligjëruesi për ligjërimin e kësaj lënde, i publikuar në Moodle 2025.
	Literatura Sekondare: 5. Basic Econometrics, Damodar Narain Gujarati, 2012. ISBN: 978-0071333450. 6. Research Methods for Business Students, Mark Saunders, Philip Lewis dhe Thornhill, 2009. ISBN: 978-0273716860.
Standartet Etike	Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t'i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe

	<p>dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me standardet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.</p>
--	--

Lënda	RREGULLIMI FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIA			
	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi
	OBLIGATIVE (O)	1	6	10FRC904
Qëllimi dhe Objektivat	<p>Lënda Rregullimi Financiar dhe Përputhshmëria (Compliance) ofron një analizë të thelluar dhe kritike të kornizës ligjore, rregullatore dhe institucionale që rregullon sistemin financiar tradicional dhe ekosistemin modern FinTech. Në kushtet e transformimit digjital të shërbimeve financiare, ku teknologjia si blockchain, inteligjenca artificiale dhe big data po riformësojnë tregjet ndërkombëtare, rregullimi financiar merr një rol thelbësor në garantimin e stabilitetit financiar, mbrojtjes së konsumatorit, integritetit të tregut dhe sigurisë së të dhënave.</p> <p>Lënda integron gjithashtu dimensionin etik të inovacionit financiar, duke shqyrtuar sfida si “black box decision-making” në algoritmet e kreditimit, diskriminimi algoritmik, transparencja dhe përgjegjësia korporative. Në këtë kontekst, theksohet balancimi midis inovacionit teknologjik dhe nevojës për mbrojtje të interesit publik.</p> <p>Objektivat e lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë rolin dhe funksionin e rregullimit financiar në garantimin e stabilitetit financiar, mbrojtjes së konsumatorit dhe integritetit të tregut në epokën digjitale. • Të zgjerojnë njohuritë mbi kornizat rregullatore kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, përfshirë rolin e institucioneve si Banka Qendrore Evropiane dhe European Banking Authority në mbikëqyrjen e tregjeve financiare. • Vlerësojnë ndikimin e legjislacionit financiar në zhvillimin e inovacionit FinTech, duke balancuar kërkesat e stabilitetit me nevojën për inovacion dhe konkurrencë. 			

	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillojnë aftësi për zbatimin praktik të standardeve të përputhshmërisë (compliance), përfshirë kërkesat AML/KYC dhe mbrojtjen e të dhënave sipas General Data Protection Regulation. • Identifikojnë dhe menaxhojnë rreziqet rregullatore, operative dhe reputacionale në organizatat financiare digjitale. 																		
Rezultatet e pritshme (RP)	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të analizojnë arkitekturën kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare të rregullimit financiar, duke shpjeguar rolin e institucioneve mbikëqyrëse si European Central Bank dhe European Banking Authority. (PLO1, PLO5) 2. Të vlerësojnë ndikimin e legjislacionit financiar dhe politikave rregullatore në stabilitetin financiar, mbrojtjen e konsumatorit dhe zhvillimin e inovacionit FinTech. (PLO5, PLO8) 3. Të aplikojnë standardet e përputhshmërisë (compliance), përfshirë kërkesat AML/KYC dhe mbrojtjen e të dhënave sipas General Data Protection Regulation, në kontekstin e institucioneve financiare digjitale. (PLO5, PLO7) 4. Të analizojnë kornizat rregullatore për Open Banking, institucionet e pagesave, EMI-të dhe rregullimin e krypto-aseteve sipas Markets in Crypto-Assets Regulation. (PLO5, PLO8, PLO2) 5. Të identifikojnë dhe menaxhojnë rreziqet rregullatore, operative dhe reputacionale në organizatat FinTech, duke propozuar mekanizma efektivë të governance dhe kontrollit të brendshëm. (PLO7, PLO8) 6. Të vlerësojnë implikimet etike dhe ligjore të përdorimit të AI, algoritmeve të kreditimit dhe teknologjive blockchain në financë, përfshirë sfidat e “black-box decision-making”. (PLO1, PLO8) 7. Të hartojnë një kornizë të integruar të compliance dhe menaxhimit të rrezikut për një organizatë ose startup FinTech, duke demonstruar aftësi analitike, kritike dhe praktike. (PLO1, PLO2) 																		
Përmbajtja	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="464 1247 1268 1310">Përmbajtja javore</th> <th data-bbox="1268 1247 1484 1310">Java</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="464 1310 1268 1415">Hyrje në rregullimin financiar - Objektivat, parimet dhe teoritë e rregullimit.</td> <td data-bbox="1268 1310 1484 1415">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="464 1415 1268 1478">Arkitektura globale e mbikëqyrjes financiare.</td> <td data-bbox="1268 1415 1484 1478">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="464 1478 1268 1541">Rregullimi bankar ndërkombëtar dhe standardet</td> <td data-bbox="1268 1478 1484 1541">3</td> </tr> <tr> <td data-bbox="464 1541 1268 1604">Open Banking - Transformimi i tregut të pagesave në BE.</td> <td data-bbox="1268 1541 1484 1604">4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="464 1604 1268 1667">Rregullimi i institucioneve të pagesave dhe EMI-ve.</td> <td data-bbox="1268 1604 1484 1667">5</td> </tr> <tr> <td data-bbox="464 1667 1268 1730">GDPR dhe mbrojtja e të dhënave në FinTech.</td> <td data-bbox="1268 1667 1484 1730">6</td> </tr> <tr> <td data-bbox="464 1730 1268 1793">Blockchain dhe rregullimi i krypto-aseteve (MiCA).</td> <td data-bbox="1268 1730 1484 1793">7</td> </tr> <tr> <td data-bbox="464 1793 1268 1877">Mbrojtja e konsumatorit në shërbimet financiare digjitale.</td> <td data-bbox="1268 1793 1484 1877">8</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbajtja javore	Java	Hyrje në rregullimin financiar - Objektivat, parimet dhe teoritë e rregullimit.	1	Arkitektura globale e mbikëqyrjes financiare.	2	Rregullimi bankar ndërkombëtar dhe standardet	3	Open Banking - Transformimi i tregut të pagesave në BE.	4	Rregullimi i institucioneve të pagesave dhe EMI-ve.	5	GDPR dhe mbrojtja e të dhënave në FinTech.	6	Blockchain dhe rregullimi i krypto-aseteve (MiCA).	7	Mbrojtja e konsumatorit në shërbimet financiare digjitale.	8
Përmbajtja javore	Java																		
Hyrje në rregullimin financiar - Objektivat, parimet dhe teoritë e rregullimit.	1																		
Arkitektura globale e mbikëqyrjes financiare.	2																		
Rregullimi bankar ndërkombëtar dhe standardet	3																		
Open Banking - Transformimi i tregut të pagesave në BE.	4																		
Rregullimi i institucioneve të pagesave dhe EMI-ve.	5																		
GDPR dhe mbrojtja e të dhënave në FinTech.	6																		
Blockchain dhe rregullimi i krypto-aseteve (MiCA).	7																		
Mbrojtja e konsumatorit në shërbimet financiare digjitale.	8																		

	Etika, AI dhe “black box decision-making” në financë.	9
	Menaxhimi i rrezikut rregullator dhe governance në FinTech.	10
	RegTech dhe SupTech - Teknologjia në përputhshmërinë rregullatore dhe mbikëqyrje	11
	Rregullimi i sigurisë kibernetike dhe rezilienca operacionale në financat digjitale (korniza DORA)	12
	AI, automatizimi dhe “black-box decision-making” në financë.	13
	Prezantime të projekteve dhe diskutime përfundimtare.	14
	Provimi përfundimtar.	15
Metodat e mësimdhenies	Aktiviteti	Pesha (%)
	Ligjërata interaktive	30 %
	Diskusione të strukturuar mbi legjislacionin aktual	20 %
	Simulime të proceseve të compliance	20 %
	Raste studimi	10 %
	Hulumtim individual dhe prezantime	10 %
	Mësim i bazuar në probleme	10 %
Metodat e vlerësimit	Aktiviteti i vlerësimit	Pesha (%)
	Pjesëmarrja dhe Aktiviteti	30 %
	Raste studimi	20 %
	Projekt në grup	20 %
	Provimi final	30 %

<p>Përshkrimi i Vlerësimit</p>	<p>Pjesëmarrja dhe Aktiviteti në Klasë (30%) - Studentët vlerësohen bazuar në pjesëmarrjen aktive në diskutime, ushtrime analitike dhe angazhimin me temat javore rregullatore. Theksi vihet në mendimin kritik dhe aftësinë për të lidhur teorinë me zhvillimet praktike në fushën e rregullimit financiar. (Adreson RP1, RP2, RP5)</p> <p>Studime Rasti (20%) - Studentët analizojnë skenarë praktikë rregullatorë që lidhen me AML/KYC, GDPR, Open Banking, MiCA dhe mbrojtjen e konsumatorit. Vlerësimi fokusohet në saktësinë rregullatore, identifikimin e rreziqeve dhe propozimin e zgjidhjeve praktike të përputhshmërisë (compliance). (Adreson RP2, RP3, RP4, RP5)</p> <p>Projekt në Grup (20%) - Studentët hartojnë një kornizë të integruar të përputhshmërisë dhe menaxhimit të rrezikut për një institucion FinTech, duke përfshirë qeverisjen, AML/KYC, GDPR dhe hartëzimin rregullator. Projekti vlerëson thellësinë analitike dhe aftësitë për zbatim praktik. (Adreson RP3, RP5, RP6, RP7)</p> <p>Provimi Final (30%) - Provimi final vlerëson kuptimin e plotë të kornizave rregullatore financiare, institucioneve mbikëqyrëse, rregullimit të financës digjitale dhe qeverisjes së rrezikut. Studentët vlerësohen mbi bazën e arsytimit analitik dhe aplikimit të njohurive rregullatore në praktikë. (Adreson RP1, RP2, RP4, RP5, RP6)</p>												
<p>Burimet dhe mjetet e konkretizimit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="456 842 1268 884">Burimet</th> <th data-bbox="1268 842 1484 884">Numri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="456 884 1268 947">Klasë</td> <td data-bbox="1268 884 1484 947">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 947 1268 1010">Laborator IT</td> <td data-bbox="1268 947 1484 1010">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1010 1268 1073">Moodle</td> <td data-bbox="1268 1010 1484 1073">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1073 1268 1136">Windows 11, MS Office 2021</td> <td data-bbox="1268 1073 1484 1136">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1136 1268 1241">LCD Projector</td> <td data-bbox="1268 1136 1484 1241">1</td> </tr> </tbody> </table>	Burimet	Numri	Klasë	1	Laborator IT	1	Moodle	1	Windows 11, MS Office 2021	1	LCD Projector	1
Burimet	Numri												
Klasë	1												
Laborator IT	1												
Moodle	1												
Windows 11, MS Office 2021	1												
LCD Projector	1												
<p>ECTS Ngarkesa</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="456 1241 1268 1283">Aktiviteti</th> <th data-bbox="1268 1241 1484 1283">Ngarkesa Totale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="456 1283 1268 1346">Ligjërata</td> <td data-bbox="1268 1283 1484 1346">30</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1346 1268 1409">Seminar</td> <td data-bbox="1268 1346 1484 1409">30</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1409 1268 1472">Mësim i Pavarur</td> <td data-bbox="1268 1409 1484 1472">87</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1472 1268 1577">Konsultime</td> <td data-bbox="1268 1472 1484 1577">3</td> </tr> </tbody> </table>	Aktiviteti	Ngarkesa Totale	Ligjërata	30	Seminar	30	Mësim i Pavarur	87	Konsultime	3		
Aktiviteti	Ngarkesa Totale												
Ligjërata	30												
Seminar	30												
Mësim i Pavarur	87												
Konsultime	3												
<p>Literatura/Referencat</p>	<p>Literatura primare:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li data-bbox="516 1619 1484 1682">1. Coyle, B. (2021). Financial Regulation and Compliance. Oxford University Press. <li data-bbox="516 1692 1484 1755">2. Arner, D., Barberis, J., Buckley, R. (2020). FinTech, RegTech and the Reconceptualization of Financial Regulation. Cambridge University Press. <li data-bbox="516 1766 1484 1797">3. FinTech: Law and Regulation (Madir, 2024). <li data-bbox="516 1808 1484 1871">4. Alexander Dill (2021). Anti-Money Laundering Regulation and Compliance. Edward Elgar Publishing. 												

	<p>Literatura sekondare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. Arner, D., Barberis, J., Buckley, R. – Artikuj mbi FinTech & RegTech 6. Literatura mbi AML/CFT dhe menaxhimin e rrezikut 7. Dokumente zyrtare rregullatore evropiane dhe ndërkombëtare 8. Artikuj shkencorë nga revista: Journal of Financial Regulation, European Organization Law Review
<p>Standartet etike</p>	<p>Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t'i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me standartet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.</p>

<p>Lënda</p>	<p>ANALIZA E TË DHËNAVE DHE INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË FINANCË</p> <table border="1" data-bbox="462 1602 1476 1730"> <thead> <tr> <th>Lloji</th> <th>Semesteri</th> <th>ECTS</th> <th>Kodi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>OBLIGATIVE (O)</td> <td>2</td> <td>6</td> <td>10DAAIF926</td> </tr> </tbody> </table>	Lloji	Semesteri	ECTS	Kodi	OBLIGATIVE (O)	2	6	10DAAIF926
Lloji	Semesteri	ECTS	Kodi						
OBLIGATIVE (O)	2	6	10DAAIF926						
<p>Qëllimi dhe Objektivat</p>	<p>Lënda trajton aplikimin e metodave të avancuara të analizës së të dhënave dhe inteligjencës artificiale në sektorin financiar. Kursi fokusohet në analizën e të dhënave financiare, menaxhimin e riskut, credit scoring, zbulimin e mashtrimeve, analizën e</p>								

	<p>performancës së portofolit dhe ndërtimin e dashboard-eve për vendimmarrje strategjike.</p> <p>Lënda integron teori analitike, modelim statistik dhe implementim praktik përmes Python dhe Power BI. Studentët do të punojnë me dataset-e reale financiare dhe do të zhvillojnë modele analitike dhe vizualizime interaktive për mbështetje të vendimmarrjes në banking dhe fintech.</p> <p>Gjithashtu, trajtohen aplikimet e Inteligjencës Artificiale në financë, përfshirë machine learning për kredi, zbulim anomalish dhe përdorimin e AI në automatizimin e proceseve financiare, duke analizuar edhe aspektet rregullative dhe etike.</p> <p>Objektivat e lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Të thellojë njohuritë mbi analizën e të dhënave në sektorin financiar. ● Të zhvillojë aftësi për analizë të dataset-eve financiare me Python. ● Të aplikojë modele statistikore dhe predictive në risk dhe kredi. ● Të zhvillojë aftësi për vizualizim profesional financiar me Power BI. ● Të analizojë aplikimet e AI në financë dhe implikimet rregullative. 										
<p>Rezultatet e pritshme (RP)</p>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të analizojë dataset-e financiare duke përdorur metodologji të strukturuar analitike. (PLO4) 2. Të vlerësojë riskun financiar dhe performancën e modeleve analitike. (PLO4, PLO8) 3. Të zhvillojë modele predictive për credit scoring, risk assessment ose analizë performance. (PLO1, PLO4) 4. Të interpretojë seri kohore financiare dhe tregues të riskut. (PLO4, PLO8) 5. Të gjykojë implikimet etike dhe rregullative të përdorimit të analytics dhe AI në financë. (PLO5, PLO8) 6. Të projektojë dashboard-e financiare interaktive për vendimmarrje strategjike. (PLO4, PLO9) 7. Të kryejë kërkime analitike të aplikuara duke përdorur të dhëna financiare dhe të komunikojë rezultate dhe konkluzione të bazuara në evidencë. (PLO4, PLO10) 										
<p>Përmbajtja</p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Plani Javorë</th> <th style="text-align: right;">Java</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ekosistemi i të Dhënave Financiare & Korniza e Analizës</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>CRISP-DM në Financë</td> <td style="text-align: right;">2</td> </tr> <tr> <td>Financial Data Structures & Sources</td> <td style="text-align: right;">3</td> </tr> <tr> <td>Python për Analizë të të Dhënave Financiare</td> <td style="text-align: right;">4</td> </tr> </tbody> </table>	Plani Javorë	Java	Ekosistemi i të Dhënave Financiare & Korniza e Analizës	1	CRISP-DM në Financë	2	Financial Data Structures & Sources	3	Python për Analizë të të Dhënave Financiare	4
Plani Javorë	Java										
Ekosistemi i të Dhënave Financiare & Korniza e Analizës	1										
CRISP-DM në Financë	2										
Financial Data Structures & Sources	3										
Python për Analizë të të Dhënave Financiare	4										

	Përgatitja dhe Pastrimi i të Dhënave Financiare	5
	Risk Metrics & Financial KPIs	6
	Testi 1	7
	Credit Scoring - Modele Regresioni & Klasifikimi	8
	Fraud Detection & Anomaly Detection	9
	Analiza e Serive Kohore Financiare	10
	Hyrje në Power BI për Raportimin Financiar	11
	Advanced Financial Dashboards & KPI Monitoring	12
	Artificial Intelligence në Financë I (Machine Learning në Banking & FinTech)	13
	Artificial Intelligence në Financë II & Aspekte Rregullative/Etiqe	14
	Prezantimi i Projekteve & Vlerësimi Final	15
Metodat e mësimdhënies	Aktivitetet	Pesha (%)
	Ligjërata	30%
	Laborator	30%
	Raste studimi	15%
	Mësimi bazuar në problem	10%
	Punë grupore	15%
Metodat e vlerësimit	Aktivitetet e vlerësimit	Pesha (%)
	Pjesëmarrja dhe Aktiviteti	10%
	Testet	30%
	Projekti	25%
	Provimi Final	35%
Përshkrimi i Vlerësimit	Pjesëmarrja dhe Aktiviteti - Vlerëson diskutimin analitik, interpretimin financiar dhe angazhimin në ushtrimet praktike laboratorike. (Adreson RP1, RP2)	

	<p>Projekti - Studentët analizojnë një grup të dhënash financiare reale (p.sh., grup të dhënash krediti, grup të dhënash transaksioni) duke përdorur Python dhe hartojnë një panel kontrolli financiar në Power BI. (Adreson RP3, RP4, RP6)</p> <p>Testet - Vlerësime praktike dhe teorike që vlerësojnë teknikat e analizës së të dhënave financiare. (Adreson RP - RP4)</p> <p>Provimi Final - Vlerësim i integruar teorik dhe i aplikuar që mbulon të gjitha kompetencat e kursit. (Adreson të gjitha RP)</p>												
Burimet dhe mjetet e konkretizimit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Burimet</th> <th>Numri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Klasë</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Laborator IT</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Moodle</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Windows 11, MS Office 2021</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>LCD Projector</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>	Burimet	Numri	Klasë	1	Laborator IT	1	Moodle	1	Windows 11, MS Office 2021	1	LCD Projector	1
	Burimet	Numri											
	Klasë	1											
	Laborator IT	1											
	Moodle	1											
Windows 11, MS Office 2021	1												
LCD Projector	1												
ECTS Ngarkesa	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Aktiviteti</th> <th>Ngarkesa Totale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ligjërata</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>Simulime dhe pune grupore</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>Mësim i Pavarur</td> <td>117</td> </tr> <tr> <td>Konsultimet</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>	Aktiviteti	Ngarkesa Totale	Ligjërata	15	Simulime dhe pune grupore	15	Mësim i Pavarur	117	Konsultimet	3		
	Aktiviteti	Ngarkesa Totale											
	Ligjërata	15											
	Simulime dhe pune grupore	15											
Mësim i Pavarur	117												
Konsultimet	3												
Literatura/Referencat	<p>Literatura primare</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Wes McKinney – <i>Python for Data Analysis</i> (3rd Edition, 2022) 2. Alberto Ferrari & Marco Russo – <i>Analyzing Data with Power BI and Power Pivot</i> <p>Literatura sekondare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. Foster Provost & Tom Fawcett – <i>Data Science for Business</i> (2019 edition) 4. Materiale të përgatitura nga ligjëruesi (Moodle). 												
	Standartet etike	<p>Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t'i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p>											

	<p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përfshirë referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me standardet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.</p>
--	---

Lënda	BANKIMI DIGJITAL DHE SISTEMET E PAGESAVE			
	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi
	OBLIGATIVE (O)	2	6	10DBPS927
Qëllimi dhe Objektivat	<p>Kjo lëndë nxit angazhimin e avancuar dhe kritik me modelet e bankave dixhitale dhe infrastrukturat e sistemeve të pagesave në kontekstin e evolucionit të shpejtë të fintech. Studentët do të sintetizojnë njohuritë e tranzicionit nga arkitekturat bankare të trashëguara në platformat financiare të integruara dixhitalisht, duke theksuar implikimet strategjike të pagesave në kohë reale, kornizave të hapura bankare, API-ve dhe teknologjive në zhvillim.</p> <p>Studentët do të zbërthejnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike strukturat operacionale dhe rolet strategjike të shënave moderne të pagesave, duke përfshirë sistemet RTGS, rrjetet ACH, skemat e kartave dhe infrastrukturat e pagesave të menjëhershme. Lënda i sfidon studentët të shqyrtojnë dhe vlerësojnë faktorët nxitës të inovacionit që formësojnë peizazhin e financave dixhitale, siç janë financat e integruara, portofolet dixhitale, pagesat e bazuara në blockchain dhe Monedhat Dixhitale të Bankës Qendrore (CBDC).</p> <p>Përmes analizës dhe vlerësimit rigoroz, studentët do të shqyrtojnë kornizat rregullatore, kërcënimet e sigurisë kibernetike, menaxhimin e rrezikut të mashtrimit dhe kompleksitetet e pajtueshmërisë në shërbimet financiare dixhitale. Theksohet inovacioni strategjik, duke kërkuar që studentët të hartojnë dhe justifikojnë analizat e drejtuara nga inteligjenca artificiale dhe proceset e vendimmarrjes të bazuara në të dhëna brenda bankës dixhitale.</p> <p>Duke integruar perspektivat teknologjike, rregullatore dhe të menaxhimit të riskut, studentët do të fuqizohen për të analizuar, vlerësuar dhe krijuar zgjidhje të fuqishme të bankave dhe pagesave dixhitale që përputhen me parimet bashkëkohore të menaxhimit të inovacionit dhe ruajnë stabilitetin e sistemit financiar.</p>			

	<p>Objektivat e lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë arkitekturën e bankave dixhitale dhe infrastrukturën e pagesave brenda ekosistemeve moderne financiare. • Të vlerësojë performancën dhe mekanizmat operativë të sistemeve bashkëkohore të pagesave • Për të vlerësuar kornizat rregullatore dhe të pajtueshmërisë që rregullojnë shërbimet financiare dixhitale • Për të hartuar zgjidhje dixhitale bankare dhe pagesash të orientuara drejt inovacionit • Të formulojë qasje për zbutjen e rrezikut që adresojnë sigurinë kibernetike dhe kërcënimet operacionale në ekosistemet e pagesave dixhitale
<p>Rezultatet e pritshme (RP)</p>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Analizojnë dhe sintetizojnë në mënyrë kritike strukturat operacionale dhe ndërvarësitë e sistemeve bashkëkohore dixhitale bankare dhe rrjeteve të pagesave, duke u mbështetur në korniza teorike të avancuara. (PLO1, PLO3) 2. Vlerësojnë dhe krahasojnë sistematikisht sistemet tradicionale dhe ato në zhvillim të pagesave, duke përfshirë pagesat e menjëhershme, rrjetet e kartave dhe mekanizmat e bazuar në blockchain, duke përdorur kritere të avancuara vlerësimi. (PLO1, PLO2) 3. Vlerësojnë kornizat rregullatore dhe kërkesat e pajtueshmërisë për shërbimet dixhitale bankare dhe të pagesave në një nivel strategjik. (PLO5, PLO8) 4. Hartojnë dhe formulojnë i zgjidhjeve inovative të bankave dixhitale ose pagesave në përputhje me trendet aktuale dhe në zhvillim të fintech, duke i mbështetur zgjedhjet me kërkime shkencore. (PLO1, PLO3) 5. Vlerësojnë në mënyrë kritike dhe propozoni strategji zbutëse për dobësitë e sigurisë dhe rreziqet e mashtrimit në mjediset e bankave dixhitale. (PLO7, PLO8) 6. Zhvillojnë dhe justifikoni përgjigjet strategjike ndaj ndërprerjeve të shkaktuara nga fintech në sistemet bankare dhe të pagesave, duke integruar perspektiva shumëdisiplinore. (PLO1, PLO3) 7. Sintetizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike ndikimin transformues të infrastrukturave në zhvillim, të tilla si CBDC-të dhe ekosistemet e hapura

	bankare, në sistemet financiare të ardhshme, të mbështetura nga kërkime të thelluara. (PLO1, PLO2)
Përmbajtja	Plani Javor Java
	Hyrje në Bankën Dixhitale dhe Sistemet e Pagesave 1
	Bazat Teorike të Bankës Dixhitale 2
	Struktura dhe Funkcionimi i Rrjeteve Moderne të Pagesave 3
	Pagesa të menjëhershme dhe sisteme pagesash në kohë reale 4
	Rrjetet e Kartave - Arkitektura dhe Proceset 5
	Blockchain, Kriptomonedhat dhe Regjistrat e Shpërndarë 6
	Kornizat Rregullatore në Bankën Dixhitale 7
	Pajtueshmëria dhe Menaxhimi i Riskut në Sistemet e Pagesave 8
	Testi i mesit të semestrit 9
	Identiteti Dixhital dhe Autentifikimi në Financë 10
	Inovacionet Fintech dhe Teknologjitë Disruptive 11
	Infrastruktura në Zhvillim—CBDC-të dhe Bankat e Hapura 12
	Menaxhimi Strategjik në Bankën Dixhitale 13
	Testi përfundimtar 14
Përmbyllja e lëndës, Prezantimet e Projekteve dhe Reflektimet 15	
Metodat Mësimdhënies	Aktivitetet Pesha (%)
	Ligjërata interaktive: Ofrimi i teorive të avancuara dhe lehtësimi i pyetjeve kritike për të ndërtuar aftësi themelore dhe analitike. 20%
	Studime Rastesh dhe Skenarë të Botës Reale: Analiza dhe vlerësimi i shembujve praktikë në bankën dixhitale dhe fintech për të zhvilluar aftësi zgjidhjeje problemesh dhe vlerësuese. 20%
	Seminare dhe Diskutime të Udhëhequra nga Studentët: Prezantime, debate dhe eksplorim bashkëpunues nga studentët për të inkurajuar sintezën, reflektimin dhe të menduarit e nivelit të lartë. 15%

	Mësim i Bazuar në Probleme: Hetim dhe zgjidhje në grup e problemeve komplekse të botës reale, duke theksuar inovacionin dhe krijimin.	15%
	Projekte Kërkimore dhe Prezantime: Kërkime të pavarura ose në grup të fokusuara në sintezë dhe zgjidhje inovative, që kulmojnë me prezantime formale.	20%
	Simulime, Lojëra me Role: Ushtrime përvojë, mësimdhënie dhe detyra bashkëpunuese për të zbatuar teorinë, për të nxitur punën në grup dhe për të thelluar të kuptuarit praktik.	7%
	Vlerësime reflektive: Shkrime të rregullta reflektive dhe vlerësime të strukturuar (kuize, provime të mes-semestrit dhe provime përfundimtare) që synojnë të nxisin reflektimin kritik dhe të mundësojnë monitorimin e vazhdueshëm të progresit të studentëve	3%
	Aktiviteti i Vlerësimit	Pesha (%)
Metodat e Vlerësimit	1. Pjesëmarrja dhe Aktiviteti në Orën e Mësimit (20%): Pjesëmarrja, angazhimi në diskutime dhe kontributi në aktivitetet e orës së mësimit.	20%
	2. Testi 1 dhe 2 (50%): Vlerësim me shkrim që përqendrohet në analizën, zbatimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së lëndës.	50%
	4. Projekte në Grup (15%): Detyra bashkëpunuese si studime rastesh, projekte të bazuara në probleme ose prezantime kërkimore, duke theksuar punën në grup, sintezën dhe krijimin.	15%
	5. Detyra Individuale (15%): Analiza të shkruara rastesh, revista reflektuese ose punime semestrale që vlerësojnë aftësitë e të menduarit kritik, analitike dhe vlerësuese.	15%
Përshkrimi i Vlerësimit	<p>Pjesëmarrja dhe Aktiviteti në Mësim - instrument që vlerëson angazhimin analitik dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutime që lidhen me modelet e bankave dixhitale dhe infrastrukturën e sistemeve të pagesave. Gjatë leksioneve, studentët do të inkurajohen të interpretojnë konceptet, të vlerësojnë në mënyrë kritike shembuj rastesh financiare dixhitale dhe të kontribuojnë në diskutime mbi zhvillimet rregullatore dhe teknologjike në financat dixhitale. (Adresohet RP1 dhe RP3)</p> <p>Projekte në Grup - aplikohen gjatë gjithë semestrit dhe grumbullojnë 15% të vlerësimit të përgjithshëm. Studentët do të punojnë në bashkëpunim për të sintetizuar njohuritë e lëndës dhe për të hartuar zgjidhje bankare dixhitale ose pagesash të orientuara nga inovacioni, duke adresuar sfidat e botës reale të teknologjisë financiare. (Adreson RP4 dhe RP6)</p>	

	<p>Detyrë Individuale - zbatohet gjatë gjithë semestrit dhe akumulon 15% të vlerësimit të përgjithshëm. Studentët do të kryejnë vlerësime analitike të rasteve të bankave dixhitale ose të sistemeve të pagesave, duke demonstruar aftësinë e tyre për të vlerësuar mekanizmat operacionalë, rreziqet dhe implikimet e pajtueshmërisë. (Adreson RP2 dhe RP5)</p> <p>Testi 1 dhe Testi 2 - Studentët do t'i nënshtrohen dy vlerësimeve me shkrim gjatë semestrit. Vlerësimi i parë kryhet në javën 7, ndërsa i dyti kryhet në javën 14. Këto vlerësime vlerësojnë aftësinë e studentëve për të analizuar arkitekturat e bankave dixhitale, për të aplikuar njohuritë konceptuale në skenarët e sistemeve të pagesave dhe për të vlerësuar kornizat rregullatore dhe teknologjike që ndikojnë në shërbimet financiare dixhitale. (Adreson RP1, RP2 dhe RP3)</p>														
Burimet dhe mjetet e konkretizimit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="456 659 1268 726">Burimet</th> <th data-bbox="1268 659 1484 726">NumRI</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="456 726 1268 793">Klasë</td> <td data-bbox="1268 726 1484 793">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 793 1268 861">Laboratori i IT-së</td> <td data-bbox="1268 793 1484 861">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 861 1268 928">Platforma Moodle</td> <td data-bbox="1268 861 1484 928">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 928 1268 995">Bazat e të dhënave financiare / Materialet e rasteve të pagesave dixhitale</td> <td data-bbox="1268 928 1484 995">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 995 1268 1062">Mjetet e Simulimit FinTech 1</td> <td data-bbox="1268 995 1484 1062">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1062 1268 1129">Projektor LCD</td> <td data-bbox="1268 1062 1484 1129">1</td> </tr> </tbody> </table>	Burimet	NumRI	Klasë	1	Laboratori i IT-së	1	Platforma Moodle	1	Bazat e të dhënave financiare / Materialet e rasteve të pagesave dixhitale	1	Mjetet e Simulimit FinTech 1	1	Projektor LCD	1
	Burimet	NumRI													
	Klasë	1													
	Laboratori i IT-së	1													
	Platforma Moodle	1													
	Bazat e të dhënave financiare / Materialet e rasteve të pagesave dixhitale	1													
	Mjetet e Simulimit FinTech 1	1													
Projektor LCD	1														
ECTS Ngarkesa	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="456 1247 1268 1314">Aktiviteti</th> <th data-bbox="1268 1247 1484 1314">Ngarkesa totale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="456 1314 1268 1381">Leksione</td> <td data-bbox="1268 1314 1484 1381">30</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1381 1268 1449">Seminare (diskutime analitike)</td> <td data-bbox="1268 1381 1484 1449">8</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1449 1268 1516">Laborator IT (analizë aplikimesh dhe sistemesh)</td> <td data-bbox="1268 1449 1484 1516">10</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1516 1268 1583">Praktikë në industri</td> <td data-bbox="1268 1516 1484 1583">10</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1583 1268 1650">Vetë-mësim (punë kërkimore dhe projektimi)</td> <td data-bbox="1268 1583 1484 1650">89</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1650 1268 1717">Konsultime</td> <td data-bbox="1268 1650 1484 1717">3</td> </tr> </tbody> </table>	Aktiviteti	Ngarkesa totale	Leksione	30	Seminare (diskutime analitike)	8	Laborator IT (analizë aplikimesh dhe sistemesh)	10	Praktikë në industri	10	Vetë-mësim (punë kërkimore dhe projektimi)	89	Konsultime	3
	Aktiviteti	Ngarkesa totale													
	Leksione	30													
	Seminare (diskutime analitike)	8													
	Laborator IT (analizë aplikimesh dhe sistemesh)	10													
	Praktikë në industri	10													
	Vetë-mësim (punë kërkimore dhe projektimi)	89													
Konsultime	3														

<p>Literatura/Referencat</p>	<p>Literatura primare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>FinTech: Financa, Teknologjia dhe Rregullimi</i>, Douglas W. Arner, Janos Barberis, Ross P. Buckley. Shtëpia Botuese e Universitetit të Kembrixhit, 2023. ISBN: 9781108831871. 2. <i>Libri PAYTECH: Manuali i Teknologjisë së Pagesave për Investitorët, Sipërmarrësit dhe Vizionarët e FinTech</i>, Susanne Chishti, Janos Barberis. Wiley, 2020. ISBN: 9781119551911. 3. <i>Manuali i Blockchain, Financave Dixhitale dhe Përfshirjes: Vëllimi 1: Kriptomonedha, FinTech, InsurTech dhe Rregullimi</i>, David Lee Kuo Chuen & Robert Deng (Redaktorë). Academic Press, 2018. ISBN: 9780128122997 <p>Literatura sekondare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zetsche, DA, Buckley, RP, Arner, DW, & Barberis, JN (2020). “Financa e Decentralizuar (DeFi): Transformimi i Sistemeve Financiare.” <i>Revista e Rregullimit Financiar</i>, 6(2), 172–203. 2. Gomber, P., Kauffman, RJ, Parker, C., & Weber, BW (2018). “Mbi Revolucionin Fintech: Interpretimi i Forcave të Inovacionit, Përçarjes dhe Transformimit në Shërbimet Financiare.” <i>Revista e Sistemeve të Informacionit të Menaxhimit</i>, 35(1), 220–265. 3. Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare. (2023). <i>Dixhitalizimi i Financës dhe Bankës: Implikimet për Mbikëqyrjen dhe Rregullimin</i> 4. McKinsey & Company. <i>Raporti Global i Pagesave (Vjetor)</i>. 5. <i>Banka Botërore. Shërbimet Financiare Dixhitale: Sfidat dhe Mundësitë.</i> 6. <i>Banka për Zgjidhje Ndërkombëtare (BIS). Inovacioni në Pagesa dhe Zgjidhje (Raportet e Fundit).</i> 7. <i>Materialet e leksioneve</i> 8. <i>Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës</i>
<p>Standardet etike</p>	<p>Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t’i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me</p>

	standardet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.
--	--

Lënda	STARTUP-ET FINTECH DHE KAPITALI NDËRMARRËS								
	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 40%; text-align: left;">Lloji</th> <th style="width: 15%; text-align: center;">Semestri</th> <th style="width: 15%; text-align: center;">ECTS</th> <th style="width: 30%; text-align: right;">Kodi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>OBLIGATIVE (O)</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">6</td> <td style="text-align: right;">10FSVC928</td> </tr> </tbody> </table>	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi	OBLIGATIVE (O)	2	6	10FSVC928
	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi					
OBLIGATIVE (O)	2	6	10FSVC928						
Qëllimi dhe Objektivat	<p>Analistët e Kapitalit Riskut luajnë një rol jetësor në lidhjen me startup-et, identifikimin e mundësive të investimit dhe ofrimin e vlerës. Lënda për Startup-et Fintech dhe Kapitalin e Rrezikut i pajis pjesëmarrësit me njohuri dhe aftësi të avancuara për këtë fushë. Kjo lëndë synon të zhvillojë kompetenca të avancuara analitike, strategjike dhe vendimmarrëse në fushat e sipërmarrjes fintech dhe kapitalit të rrezikut, t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuritë, aftësitë analitike dhe përvojën praktike të kërkuara për të punuar si Analistë të Kapitalit të Rrezikut dhe për të zhvilluar, vlerësuar dhe mbështetur startup-et me potencial të lartë, veçanërisht brenda sektorëve të shërbimeve financiare dhe fintech. Lënda i përgatit studentët të identifikojnë mundësitë e investimit, të kryejnë verifikime të hollësishme, të kuptojnë dinamikën e fondeve të kapitalit të rrezikut dhe të ndërtojnë sipërmarrje të reja të qëndrueshme përmes të mësuarit të aplikuar dhe të bazuar në ekip.</p> <p>Objektivat e lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizë kritike e strukturave të Kapitalit të Rrezikut • Realizimi i analizës së tregut dhe industrisë • Vlerësimi dhe realizimi i due diligence për startup-et • Hartimi dhe zhvillimi i startup-eve Fintech që adresojnë boshllëqet reale të tregut • Integrimi i perspektivave multidisiplinare • Forcimi i aftësive profesionale dhe të komunikimit 								
Rezultatet e pritshme (RP)	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpjegojnë dhe analizojnë strukturën dhe funksionimin e fondeve të kapitalit të rrezikut, duke përfshirë rolet e Partnerëve të Përgjithshëm dhe të Kufizuar. (PLO3, PLO9) 								

	<ol style="list-style-type: none"> 2. Analizojnë trendet e tregut Fintech, zhvillimet teknologjike dhe faktorët rregullatorë që ndikojnë në inovacionin financiar. (PLO3, PLO4) 3. Zbatojnë mjete të përshtatshme për vlerësimin e modeleve të biznesit të startup-eve, projeksioneve financiare dhe potencialit për rritje. (PLO4, PLO6) 4. Kryejnë due diligence të strukturuar për të vlerësuar rreziqet dhe mundësitë në startup-et në faza të hershme. (PLO8) 5. Zhvillojnë një koncept të realizueshëm të një venture Fintech, i mbështetur nga një propozim i qartë vlerash dhe planifikim financiar bazik. (PLO6, PLO9) 6. Prezantojnë dhe arsyetojnë vendimet për investim ose venture duke përdorur argumente logjike dhe të dhëna relevante. (PLO4, PLO9) 		
Rezultatet e pritshme (RP)	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të analizojnë strukturën dhe burimet e rreziqeve financiare, operative, teknologjike dhe rregullatore në sistemet financiare të nxitura nga teknologjia dhe platformat fintech. (PLO1, PLO8) 2. Të vlerësojnë kornizat e menaxhimit të rrezikut dhe kërkesat e përputhshmërisë rregullatore të zbatueshme për shërbimet financiare digjitale dhe institucionet fintech. (PLO5, PLO8) 3. Të analizojnë dhe interpretojnë të dhëna komplekse të rrezikut financiar dhe teknologjik duke përdorur mjete analitike dhe indikatorë digjitalë të rrezikut. (PLO4, PLO8) 			

	<ol style="list-style-type: none"> 4. Të vlerësojnë kërcënimet kibernetike dhe sfidat e mbrojtjes së të dhënave në infrastrukturat financiare digjitale dhe të propozojnë mekanizma të përshtatshëm kontrolli. (PLO7, PLO5) 5. Të dizajnojnë strategji efektive të zbutjes së rrezikut për shërbime fintech duke përfshirë bankat digjitale, sistemet me bazë blockchain dhe aplikacionet financiare të drejtuara nga IA. (PLO1, PLO8) 6. Të formulojnë korniza të integruara të qeverisjes së rrezikut për menaxhimin e rreziqeve digjitale dhe sfidave etike në mjedise financiare inovative. (PLO5, PLO8) 7. Të zhvillojnë dhe arsyetojnë zgjidhje të menaxhimit të rrezikut të bazuara në evidencë për raste reale fintech përmes hulumtimit të pavarur dhe vlerësimit kritik. (PLO4, PLO8) 		
Përmbajtja	<table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="text-align: left;">Plani Javor</td> <td style="text-align: right;">Java</td> </tr> </table>	Plani Javor	Java
	Plani Javor	Java	
	Menaxhimi i Integruar i Rrezikut në Financat e Nxitura nga Teknologjia: infrastruktura financiare digjitale dhe mjedisi i rrezikut fintech	1	
	Identifikimi i rrezikut në sistemet financiare digjitale dhe platformat fintech	2	
	Matja sasiore e rrezikut dhe analitika e rrezikut në fintech	3	
	Kornizat e menaxhimit të rrezikut në fintech: Menaxhimi i Rrezikut në Ndërmarrje (ERM) dhe qeverisja digjitale e rrezikut	4	
	Rreziku rregullator dhe përputhshmëria në fintech: rregulloret digjitale, sfidat e përputhshmërisë dhe RegTech	5	
	Rreziku i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave në shërbimet financiare	6	
	Provimi i mesëm 1	7	
	Menaxhimi i rrezikut në blockchain, sistemet e aseteve digjitale dhe DeFi	8	
	Inteligjenca Artificiale dhe rreziku algoritmik në financë	9	
Menaxhimi i rrezikut në bankat digjitale dhe sistemet e pagesave	10		
Rreziku i inovacionit dhe rreziku i startup-eve në sipërmarrjet fintech	11		

	Testimi i stresit dhe analiza e skenarëve në financat digjitale	12
	Strategjitë e zbutjes së rrezikut dhe sistemet digjitale të kontrollit të rrezikut	13
	Studime rastesh mbi rrezikun fintech dhe dizajnimi i kornizave të rrezikut	14
	Provimi i mesëm 2	15
Metodat mësimdhënies	Aktivitet	Pesha (%)
	Lectures	35 %
	Seminars	15 %
	Raste studimi	20 %
	Role play	5 %
	Mësim i bazuar në probleme	15 %
	Mësim i bazuar në projekte	10 %
Metodat e vlerësimit	Aktiviteti i vlerësimit	Pesha (%)
	Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë	10 %
	Projekte në grup	25 %
	Detyrë individuale	15 %
	Provimi i mesëm 1	25 %
	Provimi i mesëm 2	25 %
Përshkrimi i Vlerësimit	Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë (10%) - Instrument që vlerëson përkushtimin dhe angazhimin e studentëve gjatë ligjëratave dhe seminareve. Gjatë diskutimeve dhe analizave të rasteve, studentët do të inkurajohen të demonstrojnë kuptimin e koncepteve të menaxhimit të rrezikut në fintech duke analizuar skenarë rreziku dhe duke propozuar masa zbutëse. (Adreson RP1, RP2 dhe RP5)	
	Projektet në grup (25%) - Zbatohen gjatë semestrit. Studentët (3–4 anëtarë) do të analizojnë një kompani fintech ose një shërbim financiar digjital dhe do të zhvillojnë një kornizë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut (identifikim, analizë dhe	

	<p>strategji zbutjeje). Raporti i shkruar pritet të jetë rreth 2500–3000 fjalë dhe prezantohet në klasë. (Adreson RP3, RP5 dhe RP6)</p> <p>Detyra individuale (15%) - Studentët do të përgatisin një punim hulumtues (1500-2000 fjalë) mbi një temë të zgjedhur, p.sh. rreziku i blockchain/DeFi, rreziku i IA, rreziku kibernetik ose rreziku rregullator. Vlerëson aftësitë analitike dhe mendimin kritik. (Adreson RP1, RP4 dhe RP7)</p> <p>Provimet e mesme (Provimi i mesëm 1 dhe 2) (25% + 25%) - Dy vlerësime me shkrim: i pari në javën 7 dhe i dyti në javën 15. Provimet vlerësojnë njohuritë mbi identifikimin dhe matjen e rrezikut, rrezikun rregullator, rrezikun kibernetik, rrezikun e blockchain/DeFi, rrezikun e IA dhe strategjitë e zbutjes së rrezikut. Pyetjet do të jenë teorike, analitike dhe me bazë raste studimi. (Adreson të gjitha RP)</p>												
<p>Burimet dhe mjetet e konkretizimit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="456 695 1268 758">Burimet</th> <th data-bbox="1268 695 1481 758">Numri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="456 758 1268 821">Klasë</td> <td data-bbox="1268 758 1481 821">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 821 1268 884">Laborator IT</td> <td data-bbox="1268 821 1481 884">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 884 1268 947">Moodle</td> <td data-bbox="1268 884 1481 947">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 947 1268 1052">Software statistikore dhe analitike (Excel, Python ose të ngjashme)</td> <td data-bbox="1268 947 1481 1052">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1052 1268 1129">LCD Projector</td> <td data-bbox="1268 1052 1481 1129">1</td> </tr> </tbody> </table>	Burimet	Numri	Klasë	1	Laborator IT	1	Moodle	1	Software statistikore dhe analitike (Excel, Python ose të ngjashme)	1	LCD Projector	1
Burimet	Numri												
Klasë	1												
Laborator IT	1												
Moodle	1												
Software statistikore dhe analitike (Excel, Python ose të ngjashme)	1												
LCD Projector	1												
<p>ECTS Ngarkesa</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="456 1129 1268 1199">Aktiviteti</th> <th data-bbox="1268 1129 1481 1199">Ngarkesa Totale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="456 1199 1268 1262">Ligjërata</td> <td data-bbox="1268 1199 1481 1262">30</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1262 1268 1325">Seminar</td> <td data-bbox="1268 1262 1481 1325">15</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1325 1268 1388">Mësim i Pavarur</td> <td data-bbox="1268 1325 1481 1388">100</td> </tr> <tr> <td data-bbox="456 1388 1268 1465">Konsultimet</td> <td data-bbox="1268 1388 1481 1465">5</td> </tr> </tbody> </table>	Aktiviteti	Ngarkesa Totale	Ligjërata	30	Seminar	15	Mësim i Pavarur	100	Konsultimet	5		
Aktiviteti	Ngarkesa Totale												
Ligjërata	30												
Seminar	15												
Mësim i Pavarur	100												
Konsultimet	5												
<p>Literatura/Referencat</p>	<p>Literatura primare:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li data-bbox="456 1535 1481 1608">1. Hull, John C. (2023). Risk Management and Financial Institutions (6th Edition). Wiley. <li data-bbox="456 1640 1481 1671">2. Nicoletti, Bernardo (2017). The Future of FinTech. Palgrave Macmillan. <li data-bbox="456 1703 1481 1734">3. Anagnostopoulos, Ioannis (2018). FinTech and RegTech. Palgrave Macmillan. <li data-bbox="456 1766 1481 1797">4. Bessis, Joel (2015). Risk Management in Banking. Wiley. <li data-bbox="456 1829 1481 1860">5. Kou, Gang & Xu, Yue (2021). Artificial Intelligence and FinTech. Springer. 												

	<p>Literatura sekondare:</p> <p>6. Arner, Douglas; Barberis, Janos & Buckley, Ross (2019). FinTech and RegTech: Impact on Regulators and Banks.</p> <p>7. Raporte të BIS (Bank for International Settlements) mbi rreziqet e fintech dhe financat digjitale.</p> <p>8. Artikuj akademikë dhe studime rastesh të ofruara nga ligjëruesi (Moodle).</p> <p>9. Materiale dhe prezantime të ligjëruesit (Moodle).</p>
<p>Standartet etike</p>	<p>Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t'i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me standardet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.</p>

<p>Lënda</p>	<p>PRAKTIKË PROFESIONALE</p>			
	<p>Lloji</p>	<p>Semestri</p>	<p>ECTS</p>	<p>Kodi</p>
	<p>OBLIGATIVE (O)</p>	<p>3</p>	<p>6</p>	<p>10INT954</p>
<p>Qëllimi dhe Objektivat</p>	<p>Praktika profesionale (Internship) është e dizajnuar për t'u ofruar studentëve të nivelit Master në programin FinTech dhe Menaxhimi i Inovacionit mundësinë për të aplikuar njohuritë teorike të avancuara dhe aftësitë analitike në një mjedis profesional që operon</p>			

	<p>në fushën e teknologjive financiare, financave digjitale, menaxhimit të inovacionit ose ndërmarrjeve të drejtuara nga teknologjia.</p> <p>Objektivat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mundësojë që studentët të aplikojnë konceptet e FinTech, transformimit digjital dhe strategjisë së inovacionit në mjedise reale organizative. • Forcojë kompetencat analitike dhe vendimmarrjen strategjike në ekosistemet financiare dhe të inovacionit. • Ofrojë ekspozim ndaj aspekteve rregullatore, teknologjike, të sigurisë kibernetike dhe operacionale të industrive FinTech • Mbështesë zhvillimin profesional dhe ndërtimin e rrjeteve profesionale në sektorët e financave digjitale dhe inovacionit. <p>Në përfundim të praktikës, studentët duhet të dorëzojnë një Raport të Praktikës (10-15 faqe) dhe të realizojnë një prezantim përfundimtar.</p>
<p>Rezultatet e pritshme (RP)</p>	<p>Pas përfundimit të kësaj praktike, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të aplikojë teoritë e avancuara të FinTech-it dhe menaxhimit të inovacionit në një mjedis profesional pune. (PLO1, PLO3) 2. Të analizojë proceset financiare digjitale, strategjitë e inovacionit dhe modelet e biznesit të drejtuara nga teknologjia. (PLO3, PLO4) 3. Të vlerësojë praktikat rregullatore, të përputhshmërisë (compliance) dhe të menaxhimit të rrezikut brenda organizatave FinTech. (PLO5) 4. Të kontribuojë në projekte reale që lidhen me transformimin digjital, teknologjitë financiare ose iniciativat e inovacionit. (PLO1, PLO6) 5. Të demonstrojë aftësi profesionale të komunikimit dhe bashkëpunimit në ekipe multidisiplinare. (PLO9) 6. Të reflektojë në mënyrë kritike mbi praktikat organizative dhe të propozojë strategji për përmirësim. (PLO3, PLO9) 7. Të përgatisë dhe të prezantojë një raport analitik të strukturuar të praktikës në nivel Master. (PLO10)

Përmbajtja	<p>Lënda Praktika Profesionale (Internship) është e strukturuar në tri faza të integruara gjatë semestrit, duke siguruar mbikëqyrje sistematike akademike dhe angazhim profesional në fushën e FinTech-it dhe Menaxhimit të Inovacionit.</p> <p>1. Hyrja dhe Orientimi - Studentët marrin pjesë në një sesion orientues me mentorin akademik, ku shpjegohen në mënyrë të detajuar objektivat, pritjet, struktura dhe kriteret e vlerësimit të praktikës profesionale. Mentori akademik vlerëson dhe miraton institucionin ose organizatën e propozuar për praktikë, për të siguruar që organizata pritëse operon në fusha relevante si teknologjitë financiare (FinTech), financat digjitale, menaxhimi i inovacionit, bankat, institucionet rregullatore, ndërmarrjet e drejtuara nga teknologjia ose ekosistemet e start-up-eve. Gjatë kësaj faze sqarohen edhe procedurat administrative, ndërsa studentët përcaktojnë objektivat e praktikës së tyre në përputhje me rezultatet e të nxëniet të programit Master. Kjo fazë përfshin gjithashtu njohjen fillestare me organizatën pritëse, modelin e saj të biznesit, infrastrukturën digjitale, proceset e inovacionit dhe kornizën operationale.</p> <p>2. Mbikëqyrja dhe Angazhimi Profesional - Kjo fazë përfaqëson pjesën kryesore të përvojës së praktikës profesionale. Studentëve u caktohet një mentor akademik në UBT dhe një mentor nga industria brenda organizatës pritëse. Gjatë kësaj periudhe, studentët angazhohen aktivisht në detyra profesionale që mund të përfshijnë pjesëmarrje në iniciativa të transformimit digjital, operatione të teknologjive financiare, analizë të të dhënave, procese të përputhshmërisë rregullatore (compliance), zhvillim produktesh, zbatim të strategjive të inovacionit ose aktivitete të tjera që lidhen me FinTech dhe Menaxhimin e Inovacionit. Komunikimi i vazhdueshëm me mentorin akademik siguron monitorimin akademik të progresit, reflektimin mbi procesin e të nxëniet dhe përputhjen ndërmjet njohurive teorike dhe praktikës profesionale. Kjo fazë thekson zhvillimin e të menduarit analitik, sjelljen profesionale, punën në ekip dhe kuptimin strategjik të proceseve organizative.</p> <p>3. Raportimi dhe Prezantimi - Në këtë fazë kërkohet që studentët të përgatisin një raport të detajuar të praktikës profesionale, i cili demonstroi reflektim kritik dhe thellësi analitike në nivel Master. Raporti përfshin një përshkrim të detajuar të organizatës pritëse, detyrave të realizuara, kompetencave të zhvilluara, si dhe lidhjen ndërmjet njohurive akademike dhe aplikimit të tyre në praktikë. Studentët pritët gjithashtu të vlerësojnë sfidat e hasura gjatë praktikës dhe, kur është e përshtatshme, të propozojnë përmirësime strategjike ose operationale. Lënda përfundon me një prezantim formal, gjatë të cilit studentët përmbledhin përvojën e tyre profesionale, njohuritë kryesore të fituara dhe vëzhgimet strategjike para mentorit akademik.</p>	
	<p>Aktivitetet</p>	<p>Pesha (%)</p>
	<p>Praktikë në industri</p>	<p>60%</p>

Metodat e mësimdhënies	Punë e pavarur	40%	
Metodat e vlerësimit	Aktivitetet e vlerësimit	Pesha (%)	
	Performanca gjatë praktikës në industri	40%	
	Raporti i shkruar i praktikës	40%	
	Prezantimi përfundimtar	20%	
Përshkrimi i Vlerësimit	<p>Performanca gjatë praktikës në industri (40%) - Studenti do të realizojë praktikën në një organizatë që operon në fushat e FinTech-it, financave digjitale, bankave, inovacionit financiar, institucioneve rregullatore, konsulencës ose ndërmarrjeve të drejtuara nga teknologjia. Praktika u mundëson studentëve të aplikojnë njohuritë teorike të avancuara në sfida reale të biznesit dhe inovacionit. Gjatë periudhës së praktikës, studenti mbikëqyret nga një mentor nga industria, i cili vlerëson sjelljen profesionale, nivelin e angazhimit, përgjegjësitë e ndërmarra, kontributin analitik dhe performancën e përgjithshme. Në përfundim të praktikës, organizata pritëse lëshon një certifikatë zyrtare që konfirmon kohëzgjatjen e praktikës, detyrat e realizuara dhe vlerësimin e performancës. Kjo certifikatë dorëzohet te mentori akademik dhe përbën bazën për vlerësimin e kësaj pjese. (RP1- RP6)</p> <p>Raporti i shkruar i praktikës (40%) - Pas përfundimit të praktikës, studenti duhet të dorëzojë një raport të strukturuar me shkrim në format Word, me gjatësi 10-15 faqe. Raporti duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të organizatës pritëse, departamentit ku është zhvilluar praktika, detyrave dhe përgjegjësi të realizuara, reflektim analitik mbi përvojën e fituar, integrimin e njohurive teorike me aplikimin praktik, identifikimin e sfidave të hasura dhe, kur është e përshtatshme, rekomandime strategjike. Raporti duhet të demonstrojë thellësi analitike në nivel Master, mendim kritik dhe standarde profesionale të shkrimit akademik. Ai vlerësohet nga mentori akademik. (RP1, RP2, RP3, RP6, RP7)</p> <p>Prezantimi përfundimtar (20%) - Studenti duhet të përgatisë një prezantim në PowerPoint me deri 10-12 slajde, ku përmbledh përvojën e praktikës. Prezantimi duhet të shpjegojë qartë profilin e organizatës, përgjegjësitë e realizuara, kompetencat e zhvilluara, njohuritë kryesore të fituara dhe përfundimet profesionale. Prezantimi vlerësohet nga mentori akademik bazuar në qartësinë, strukturën, thellësinë analitike dhe aftësitë profesionale të komunikimit. (RP2, RP5, RP6, RP7)</p> <p>Struktura e mbikëqyrjes dhe vlerësimit - Çdo student ka dy mentorë: një mentor akademik nga programi FinTech dhe Menaxhimi i Inovacionit dhe një mentor nga industria nga organizata pritëse. Mentori nga industria vlerëson performancën profesionale të studentit, ndërsa mentori akademik vlerëson raportin e shkruar dhe prezantimin përfundimtar, si dhe përcakton notën finale bazuar në të gjitha komponentët e vlerësimit.</p>		
	Burimet dhe mjetet e konkretizimit	Mjetet	Numri
		Sallë mësimore	1

	Laborator	1
	Moodle	1
	Projektor	1
ECTS Ngarkesa	Aktiviteti	Ngarkesa Totale
	Ligjëratë hyrëse dhe sqarime administrative	4
	Praktikë profesionale në industri	90
	Konsultime me mentorin akademik	6
	Përgatitja e raportit të praktikës (hulumtim, analizë, shkrim)	40
	Përgatitja e prezantimit përfundimtar	10
Literatura/Referencat	Materiale të mbledhura gjatë realizimit të punës praktike në institucion	
Standartet etike	<p>Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t'i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me standardet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.</p>	

Lënda	<p>PROJEKT I APLIKUAR</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="462 321 836 388">Lloji</th> <th data-bbox="836 321 1047 388">Semestri</th> <th data-bbox="1047 321 1274 388">ECTS</th> <th data-bbox="1274 321 1471 388">Kodi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="462 388 836 447">OBLIGATIVE (O)</td> <td data-bbox="836 388 1047 447">3</td> <td data-bbox="1047 388 1274 447">6</td> <td data-bbox="1274 388 1471 447">10AP955</td> </tr> </tbody> </table>	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi	OBLIGATIVE (O)	3	6	10AP955
Lloji	Semestri	ECTS	Kodi						
OBLIGATIVE (O)	3	6	10AP955						
Qëllimi dhe Objektivat	<p>Qëllimi i lëndës Projekti i Aplikuar është t'u ofrojë studentëve mundësinë për të aplikuar njohuritë e avancuara dhe aftësitë analitike të fituara gjatë programit Master FinTech dhe Menaxhimi i Inovacionit, në zgjidhjen e sfidave reale të biznesit dhe teknologjisë. Lënda fokusohet në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të aplikuara që lidhen me teknologjitë financiare, inovacionin digjital, shërbimet financiare të bazuara në të dhëna dhe modelet e biznesit të bazuara në teknologji.</p> <p>Përmes kësaj lënde, studentët do të projektojnë dhe zbatojnë një projekt të aplikuar që integron njohuritë teorike me nevojat praktike të industrisë, duke nxitur mendimin kritik, inovacionin dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve brenda ekosistemit FinTech.</p> <p>Objektivat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të aplikojnë konceptet e avancuara të teknologjive financiare dhe menaxhimit të inovacionit në sfida praktike të biznesit. • Të analizojnë modelet e biznesit të FinTech-it, shërbimet financiare digjitale dhe strategjitë e inovacionit në organizata të drejtuara nga teknologjia. • Të dizajnojnë dhe zhvillojnë zgjidhje të projekteve të aplikuara që adresojnë probleme reale në FinTech ose financa digjitale • Të integrojnë analizën e të dhënave, teknologjitë digjitale dhe kornizat e inovacionit në zhvillimin e projekteve. • Të vlerësojnë aspektet rregullatore, etike dhe të menaxhimit të rrezikut që lidhen me inovacionet FinTech. • Të zhvillojnë aftësi të punës në ekip, komunikimit dhe menaxhimit të projekteve në mjedise multidisiplinare. • Të përgatisin një raport profesional të projektit dhe një prezantim që demonstroi kompetenca analitike dhe praktike në nivel Master. 								
Rezultatet e pritshme (RP)	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të aplikojnë konceptet e avancuara të FinTech-it dhe kornizat e menaxhimit të inovacionit në probleme reale të biznesit. (PLO3) 2. Të analizojnë sistemet financiare digjitale, modelet e biznesit të FinTech-it dhe ekosistemet e inovacionit duke përdorur mjete analitike. (PLO3, PLO4) 								

	<ol style="list-style-type: none"> 3. Të vlerësojnë aspektet rregullatore, etike dhe të menaxhimit të rrezikut që lidhen me inovacionin FinTech dhe shërbimet financiare digjitale. (PLO5) 4. Të dizajnojnë dhe zhvillojnë zgjidhje të aplikuara ose propozime projektesh që adresojnë sfida praktike në FinTech. (PLO3, PLO6) 5. Të punojnë në mënyrë bashkëpunuese në ekipe multidisiplinare për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të aplikuara në FinTech. (PLO9) 6. Të integrojnë analizën e të dhënave, teknologjitë digjitale dhe strategjitë e inovacionit në zhvillimin e projekteve. (PLO4, PLO6) 7. Të përgatisin dhe prezantojnë një raport profesional të projektit dhe një prezantim të bazuar në analiza dhe evidencë. (PLO10) 		
Përmbajtja	<table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 70%;">Plani Javor</td> <td style="text-align: right;">Java</td> </tr> </table>	Plani Javor	Java
	Plani Javor	Java	
	Hyrje në projektet e aplikuara në FinTech dhe Menaxhimin e Inovacionit	1	
	Përzgjedhja e temës së projektit dhe zhvillimi i propozimit të projektit	2	
	Ekosistemet e inovacionit në FinTech dhe trendet e industrisë	3	
	Modelet e biznesit në financat digjitale	4	
	Përcaktimi i problemit dhe dizajnimi i projektit	5	
	Burimet e të dhënave, analiza financiare dhe mjetet teknologjike	6	
	Menaxhimi agil i projekteve dhe design thinking në projektet FinTech	7	
	Aspektet rregullatore dhe menaxhimi i rrezikut në inovacionin FinTech	8	
	Punëtori për zhvillimin e projektit	9	
	Analiza e fizibilitetit financiar dhe krijimi i vlerës	10	
Zbatimi i projektit dhe testimi i zgjidhjeve	11		
Perspektiva nga industria / ligjërata nga mysafirë / analizë e rasteve studimore	12		

	Konsultime në grup dhe zhvillimi i projektit	13
	Prezantimet e projekteve	14
	Dorëzimi përfundimtar i projektit dhe diskutimi	15
Metodat e mësimdhënies	Aktivitetet	Pesha (%)
	Ligjërata	20%
	Studime rasti	20%
	Punëtori / zhvillimi i projektit	40%
	Diskutime në grup dhe prezantime	20%
Metodat e vlerësimit	Aktiviteti I vlerësimit	Pesha (%)
	Pjesëmarrja dhe project propozimi	10 %
	Projekti i aplikuar (raport i shkruar)	60 %
	Prezantimi përfundimtar i projektit	30 %
Përshkrimi i Vlerësimit	<p>Pjesëmarrja në klasë dhe project propozimi - Përmes këtij instrumenti të vlerësimit, studentët do të vlerësohen bazuar në pjesëmarrjen aktive në ligjërata, punëtori dhe diskutime, si dhe në përgatitjen e një propozimi projekti që përshkruan idenë e projektit, objektivat, metodologjinë dhe rezultatet e pritura. Ky komponent synon të inkurajojë studentët të demonstrojnë mendim kritik dhe aftësinë për të përcaktuar dhe strukturuar një problem praktik që lidhet me FinTech. (RP1, RP2, RP4)</p>	
	<p>Projekti i aplikuar (raport i shkruar) - Studentët duhet të përgatisin një raport të plotë të projektit të aplikuar që trajton një sfidë reale në fushën e FinTech-it ose menaxhimit të inovacionit. Raporti duhet të përfshijë një përkufizim të qartë të problemit, bazën e literaturës, metodologjinë, analizën e të dhënave ose të rastit studimor, zgjidhjet e propozuara dhe rekomandimet praktike. Raporti duhet të demonstrojë thellësi analitike, integrim të njohurive teorike dhe aplikimin e kornizave të FinTech-it ose inovacionit në situata praktike. (RP1, RP2, RP3, RP4, RP6, RP7)</p>	
	<p>Prezantimi përfundimtar i projektit - Studentët do të prezantojnë projektin e tyre të aplikuar dhe do të mbrojnë gjetjet para ligjëruesit dhe studentëve të tjerë. Vlerësimi do të fokusohet në qartësinë e prezantimit, arsyetimin analitik,</p>	

	relevancën praktike të zgjidhjes së propozuar dhe aftësinë për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe komenteve. (RP5, RP7)
Burimet dhe mjetet e konkretizimit	Mjetet Numri
	Klasë 1
	Moodle 1
	Projektor 1
	Windows 11, MS Office 2021 1
ECTS Ngarkesa	Aktiviteti Ngarkesa Totale
	Ligjërata 24
	Konsultime dhe diskutime 12
	Zhvillimi i projektit 75
	Studim i pavarur 36
	Prezantimi përfundimtar 3
Literatura/Referencat	Literatura primare:
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gomber, P., Koch, J., & Siering, M. (2017). <i>Digital Finance and FinTech: Current Research and Future Research Directions</i>. 2. Lee, I., & Shin, Y. J. (2018). <i>Fintech: Ecosystem, business models, investment decisions, and challenges</i>.
Literatura sekondare:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Blank, S., & Dorf, B. (2020). <i>The Startup Owner's Manual</i>. 4. Ries, E. (2017). <i>The Lean Startup</i>. 5. Selected academic articles from fintech and innovation management journals.
Standartet etike	<p>Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t'i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes</p>

	<p>akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me standardet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.</p>
--	---

Lënda	<p>METODAT KUANTITATIVE NË FINANCË</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Lloji</th> <th>Semesteri</th> <th>ECTS</th> <th>Kodi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>OBLIGATIVE(O)</td> <td>3</td> <td>6</td> <td>10QMF956</td> </tr> </tbody> </table>	Lloji	Semesteri	ECTS	Kodi	OBLIGATIVE(O)	3	6	10QMF956
Lloji	Semesteri	ECTS	Kodi						
OBLIGATIVE(O)	3	6	10QMF956						
Qëllimi dhe Objektivat	<p>Lënda Metodave Kuantitative në Financë synon t'u ofrojë studentëve një kuptim të thellë teorik dhe praktik mbi teknikat kryesore kuantitative që përdoren në analizën financiare moderne, me fokus të veçantë në aplikimet FinTech. Kursi nis me një hyrje në financën kuantitative, duke theksuar rolin e modeleve matematikore dhe statistikore në vlerësimin e aseteve dhe vendimmarrjen financiare. Më pas trajtohen shpërndarjet probabilitike, të cilat shërbejnë si bazë për modelimin e pasigurisë dhe çmimeve të tregut. Studentët do të thellohen në teorinë e vlerës së parasë në kohë, si dhe në përdorimin e regresionit linear (OLS) për analizë empirike, interpretim ekonomik dhe testim hipotezash. Kursi vazhdon me studimin e modelit CAPM dhe modeleve multifaktoriale, si dhe me konceptet kryesore të optimizimit të portofolit. Pjesa praktike pasurohet me simulimin Monte Carlo për çmimin e aksioneve dhe vlerësimin e riskut. Në semestër përfshihen gjithashtu temat e menaxhimit të riskut, ekonometrisë financiare, dhe përdorimit të machine learning në financë. Në fund, studentët eksplorojnë rolin e FinTech dhe analizës së të dhënave në modelet bashkëkohore të çmimit të aseteve, duke përgatitur projekte aplikative që prezantohen para përfundimit të kursit.</p> <p>Objektivat kryesore të lëndës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konceptet themelore të financës kuantitative dhe modelet matematikore në vendimmarrjen financiare. • Teorinë e vlerës së parasë në vlerësimin e instrumenteve financiare dhe projekteve investive. 								

	<ul style="list-style-type: none"> • Modelet ekonometrike dhe analiza empirike. • Modelin CAPM, dhe Simulimet Monte Carlo për vlerësimin e çmimeve të aksioneve dhe instrumenteve të tjera financiare. 																				
Rezultatet e Pritshme (RP)	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Analizon modelet matematikore dhe statistike të përdorura në financën kuantitative, duke interpretuar rolin e tyre në vlerësimin e aseteve, pasigurive të tregut dhe procesit të vendimmarrjes financiare (PLO1, PLO4). 2. Analizon dhe krahason shpërndarjet probabilitike, modelet e regresionit (OLS, Fixed dhe Random Effects), CAPM dhe modelet multifaktoriale, duke organizuar dhe demonstruar përdorimin e tyre në kontekste të ndryshme financiare (PLO3, PLO4). 3. Vlerëson efektivitetin e metodave të menaxhimit të riskut dhe teknikave të optimizimit të portofolit, duke gjykuar, eksperimentuar dhe selekton qasjet më të përshtatshme për situata të ndryshme të tregut (PLO3, PLO8). 4. Vlerëson përdorimin e simulimit Monte Carlo, ekonometrisë financiare dhe metodave të machine learning për analizën e serive kohore dhe çmimin e instrumenteve financiare, duke kritikuar kufizimet dhe forcat e secilës metodë (PLO2, PLO4). 5. Krijon modele financiare të avancuara duke dizajnuar, formuluar dhe projektuar analiza kuantitative me përdorim të FinTech, duke u bazuar në programet (Stata/SPSS/Python/R) dhe të dhënave reale, për të zhvilluar zgjidhje inovative dhe projekte aplikative në finance (PLO1, PLO10). 																				
Përmbajtja	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="462 1127 1268 1184">Plani Javor</th> <th data-bbox="1268 1127 1477 1184">Java</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="462 1184 1268 1241">Hyrje në Financën Kuantitative: Roli i metodave kuantitativ</td> <td data-bbox="1268 1184 1477 1241">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1241 1268 1297">Shpërndarjet Probabilistike në Financë</td> <td data-bbox="1268 1241 1477 1297">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1297 1268 1354">Teoria e Vlerës së Parasë në Kohë</td> <td data-bbox="1268 1297 1477 1354">3</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1354 1268 1461">Regresioni Linear në Financë: OLS, Interpretimi Ekonomik Hipotezave.</td> <td data-bbox="1268 1354 1477 1461">4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1461 1268 1518">Modeli CAPM dhe Modelet me Shumë Faktorë</td> <td data-bbox="1268 1461 1477 1518">5</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1518 1268 1575">Optimizimi i Portofolit</td> <td data-bbox="1268 1518 1477 1575">6</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1575 1268 1631">Kollokviumi 1</td> <td data-bbox="1268 1575 1477 1631">7</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1631 1268 1738">Simulimi Monte Carlo: Gjenerimi i numrave rastësor, S çmimin e aksioneve</td> <td data-bbox="1268 1631 1477 1738">8</td> </tr> <tr> <td data-bbox="462 1738 1268 1795">Menaxhimi i Riskut</td> <td data-bbox="1268 1738 1477 1795">9</td> </tr> </tbody> </table>	Plani Javor	Java	Hyrje në Financën Kuantitative: Roli i metodave kuantitativ	1	Shpërndarjet Probabilistike në Financë	2	Teoria e Vlerës së Parasë në Kohë	3	Regresioni Linear në Financë: OLS, Interpretimi Ekonomik Hipotezave.	4	Modeli CAPM dhe Modelet me Shumë Faktorë	5	Optimizimi i Portofolit	6	Kollokviumi 1	7	Simulimi Monte Carlo: Gjenerimi i numrave rastësor, S çmimin e aksioneve	8	Menaxhimi i Riskut	9
Plani Javor	Java																				
Hyrje në Financën Kuantitative: Roli i metodave kuantitativ	1																				
Shpërndarjet Probabilistike në Financë	2																				
Teoria e Vlerës së Parasë në Kohë	3																				
Regresioni Linear në Financë: OLS, Interpretimi Ekonomik Hipotezave.	4																				
Modeli CAPM dhe Modelet me Shumë Faktorë	5																				
Optimizimi i Portofolit	6																				
Kollokviumi 1	7																				
Simulimi Monte Carlo: Gjenerimi i numrave rastësor, S çmimin e aksioneve	8																				
Menaxhimi i Riskut	9																				

	Ekonometria Financiare	10
	Machine Learning në Financë	11
	FinTech dhe Analiza e të Dhënave	12
	Modelet e Çmimit të Aseteve në Tregun e Kapitalit	13
	Prezantimi i Projekteve	14
	Kollokviumi 2	15
Metodat e Mësimdhënies	Aktiviteti	Pesha (%)
	Lectures	35%
	Seminars and Exercises	35%
	Laborator IT	10%
	Raste studimi	10%
	Mësim i bazuar në probleme	10%
Metodat e Vlerësimit	Aktiviteti i vlerësimit	Pesha (%)
	Aktiviteti dhe Kuizet	10%
	Testi 1	35%
	Projekt Individual	20%
	Testi 2	35%
Përshkrimi i Vlerësimit	<p>Testi I dhe Testi II- Përfshinë një instrument afat-mesëm të vlerësimit. Dhe aplikohet nëpërmjet testit të parë i cili zhvillohet në javën e shtatë, si dhe testit të dytë në javën e fundit. Këto teste përmbajnë pyetje të shumëllojshme të cilat përfshinë pjesën praktike dhe pjesën teorike. Koha e mbajtjes se tyre është nga 45 deri në 90 minuta. (Adreson RP1- RP5).</p>	
	<p>Projekti Individual- Nëpërmjet projektit individual studentët do të harmonizojnë pjesën teorike më pjesën praktike. Vëllimi i projektit do të jetë nga 4000 deri në 4500 fjalë. Vlerësimi i projektit përfshijnë tre shtylla kryesore: strukturën, përmbajtjen, dhe prezantimin. Nëpërmjet këtij instrumenti të vlerësimit do të synojmë të arrijmë rezultatet e pritshme 2,3, 4,5, dhe 6 të vendosura në Syllabusin e lëndës. Projekti hulumtues është obligativ dhe kusht për provimin përfundimtar. (Adreson RP1, RP2, RP4, RP5).</p>	

	Aktiviteteti dhe Kuizet - NËpërmjet aktivitetit dhe kuizeve studentët do të vlerësohen gjatë diskutimeve dhe problemeve të ngritura studimore në ligjërata dhe ushtrime përgjatë semestrit. Ky instrument do të përfshijnë të gjitha rezultatet e pritshme në kuadër të lëndës. (Adreson RP1 - RP5).
Burimet dhe Mjetet e Konkretizimit	Burimet Numri
	Klasë 1
	Laborator IT 1
	Moodle 1
	Slido/Miro 1
	LCD Projector 1
	Software Stata/ Python/R 1
ECTS Ngarkesa	Aktiviteti Ngarkesa totale
	Ligjërata 24
	Seminar 12
	Ushtrime 12
	Mësim i Pavarur 87
	Konsultime 12
	Provime 3
Literatura/Referencat	Literatura Primare:
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Probability Distributions in Finance: Normal, Lognormal & Fat Tails, Michael Brenndoerfer. 2025 2. An Introduction to Quantitative Finance, Stephen Blyth. Oxford University Press, 2013. ISBN: 9780199666591. 3. Risk Management and Financial Institutions (6th Edition), John C. Hull. Wiley, 2018. ISBN: 9781119448112. 4. The Econometrics of Financial Markets, John Y. Campbell, Andrew W. Lo, A. Craig MacKinlay. ISBN: 9780691043012. 5. An Introduction to Financial Option Valuation: Mathematics, Stochastic Processes and Models, Desmond J. Higham. Cambridge University Press, 2004. ISBN: 9780521547574.
	Literatura Sekondare:
	<ol style="list-style-type: none"> 6. Investments, Zvi Bodie, Alex Kane & Alan J. Marcus. McGraw-Hill/Irwin, 2008 ISBN: 9780077261450.

	<p>7. The Economics of Money, Banking, and Financial Markets, Frederic S. M Apostolos Serletis. Pearson, 2020 (7th Canadian ed.). ISBN: 9780136647292.</p> <p>8. Customized material prepared by lecturer, available at Moddle</p> <p>9. Basic Econometrics, Damodar N. Gujarati. McGraw-Hill Education (India Limited, Chennai, 2012. ISBN: 9780073375847.</p>
<p>Standartet Etike</p>	<p>Të gjithë studentët në këtë lëndë janë të obliguar t'i përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik, ashtu siç përcaktohet në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, kopjimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paaautorizuara gjatë provimeve, kuizeve apo çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe dorëzimin e projekteve në grup që përmbajnë punën e të tjerëve pa njohje të duhur të kontributit të tyre.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen përmes softuerit kundër plagjiaturës Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, ndërsa për nivelin Master nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, kopjimi gjatë provimeve apo kuizeve, apo çdo formë tjetër e sjelljes akademike jo të ndershme do të rezultojnë me ndëshkime, përfshirë notë negative për detyrën ose lëndën, dhe mund të çojnë në masa të mëtejshme disiplinore sipas politikave të Kolegjit UBT.</p> <p>Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronësinë intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacione lidhur me standardet etike dhe pasojat e shkeljeve, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës të UBT-së, i cili gjendet në doracakun e studentëve ose në faqen zyrtare të kolegjit.</p>

<p>Lënda</p>	<p>DESIGN THINKING PËR SHËRBIMET FINANCIARE</p>			
	<p>Lloji</p>	<p>Semesteri</p>	<p>ECTS</p>	<p>Kodi</p>
	<p>ZGJEDHORE (Z)</p>	<p>2</p>	<p>6</p>	<p>10DTFS930</p>
<p>Qëllimi dhe Objektivat</p>	<p>Kjo lëndë prezanton të menduarit dizajnues (design thinking) si një qasje inovative të orientuar drejt përdoruesit, e aplikuar në zhvillimin e shërbimeve financiare digjitale dhe zgjidhjeve FinTech. Lënda trajton mënyrën se si institucionet financiare dhe kompanitë fintech projektojnë produkte dhe shërbime financiare të orientuara ndaj klientit në kushte të transformimit të shpejtë teknologjik dhe kompleksitetit rregullator.</p> <p>Studentët mësojnë të identifikojnë nevojat e përdoruesve, të analizojnë përvojën e klientit dhe të transformojnë sfidat e shërbimeve financiare në mundësi inovacioni përmes procesit iterativ të design thinking (Empathize–Define–Ideate–Prototype–</p>			

	<p>Test). Lënda integron konceptet e service design, menaxhimit të inovacionit dhe transformimit digjital financiar, duke marrë parasysh kufizimet sektoriale si rregullimi financiar, menaxhimi i riskut, siguria kibernetike, privatësia e të dhënave dhe aspektet etike.</p> <p>Përmes rasteve të studimit, punës praktike dhe projekteve aplikative, studentët zhvillojnë aftësi praktike në ideim, prototipim, testim dhe vlerësim të zgjidhjeve inovative për sfida reale në sektorin financiar.</p> <p>Objektivat e lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Të zhvillojë kompetenca në kërkimin e përdoruesit dhe analizën e nevojave në shërbimet financiare ● Të aplikojë metoda ideimi dhe vlerësimi të koncepteve inovative FinTech ● Të dizajnojë dhe prototipojë në mënyrë iteruese shërbime financiare digjitale ● Të integrojë kërkesat rregullatore, menaxhimin e riskut, sigurinë kibernetike dhe etikën në procesin e dizajnit ● Të komunikojë dhe prezantojë profesionalisht zgjidhje inovative financiare 								
<p>Rezultatet e pritshme (RP)</p>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të analizojnë nevojat dhe sjelljet e klientëve në shërbimet financiare digjitale duke përdorur qasje human-centred. (PLO1, PLO6) 2. Të vlerësojnë sfidat e shërbimeve financiare duke përdorur kornizat e design thinking. (PLO3, PLO6) 3. Të dizajnojnë produkte dhe shërbime inovative FinTech në përputhje me nevojat e tregut dhe përdoruesve. (PLO3, PLO9) 4. Të zhvillojnë dhe testojë prototipe të zgjidhjeve financiare digjitale përmes proceseve iterative të inovacionit. (PLO6, PLO1) 5. Të vlerësojnë implikimet etike, rregullatore dhe të riskut në inovacionin financiar. (PLO5, PLO8) 6. Të formulojnë strategji inovacioni për organizatat FinTech. (PLO3, PLO9) 7. Të realizojnë dhe mbrojnë projekte inovacioni financiar të bazuara në evidencë. (PLO9, PLO6) 								
